



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

Krijohen Klubet e Teatrit në gjimnazet e Tiranës. Nga periferia në qendër, një projekt i rëndësishëm i programit “Edukim Përmes Kulturës”

2018-01-29 12:00:00



“Edukim dhe zbavitje”- e quajti Ministria Kumbaro projektin më të ri të programit “Edukim Përmes Kulturës” në takimin me nxënësit e gjimnazit “Sandër Prosi” në Tiranë. Ministria e Kulturës bashkë me drejtorin e Teatrit Kombëtar ishin aty për ti njohur të rinjtë më në detaje me projektin e quajtur “Klubi i Teatrit”, i cili hartohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

“Edukim dhe zbavitje”- e quajti Ministria Kumbaro projektin më të ri të programit “Edukim Përmes Kulturës” në takimin me nxënësit e gjimnazit “Sandër Prosi” në Tiranë.

Ministria e Kulturës bashkë me drejtorin e Teatrit Kombëtar ishin aty për ti njohur të rinjtë më në detaje me projektin e quajtur “Klubi i Teatrit”, i cili hartohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Teatri Kombëtar ka nisur bashkëpunimin me shkollat e arsimit të mesëm në projektet:

- Festivali i Klubeve të Teatrit
- Debate artistike
- Trajtime në grupe sipas prirjeve në fushën e teatrit

“Krijojmë dhe ndërtojmë bashkë me ju këtë klub teatri si një projekt pilot që mendojmë të shtrihet vitin e ardhshëm në të gjithë vendin”- shtoi Kumbaro në fjalën e saj.

Në kuadër të programit “Edukimi përmes Artit dhe Kulturës”, si një nga prioritetet e Ministrisë së Kulturës 2017-2021 do të organizohet Festivali i Klubeve të Teatrit, punë e cila ka nisur nga shtatori i vitit 2017 dhe pritet të përfundojë në muajin maj 2018.

Në ndihmë të gjimnazistëve të cilët do të angazhohen në ndërtimin e një shfaqjeje e që është në vijimësi me programet mësimore, regjisor Armando Bora dhe dy aktorë të rinj të Teatrit Kombëtar Gjergj Mena dhe Xhuliano Brisku transmetuan tek gjimnazistët njohuritë dhe eksperiencat e tyre.

Teatri Kombëtar ka hartuar strategjinë e “Edukimit përmes artit e kulturës” me projektin Festivali i klubeve të teatrit në shkollat e arsimit të mesëm, si një projekt pilot për sezonin 2017-2018 dhe në sezonet e ardhshëm, urojmë të shtrihet, në më shumë zona periferike dhe në qytete të tjera të Shqipërisë.

Grupi i TK ka nisur hartimin e këtij projekti në muajin Shtator 2017 për përzgjedhjen, ngritjen, nxitjen dhe mbështetjen e grupeve të Klubit të Teatrit në shkollat e arsimit të mesëm dhe në shkollat periferike të Tiranës. Ky projekt do të finalizohet me realizimin e një produksioni teatror nga klubet e teatrit të çdo gjimnazi, duke u mbështetur në programet e tyre shkollore dhe programit të provimeve të letërsisë.

Gjimnazet që do të jenë pjesë e këtij projekti janë:

- Gjimnazi “Sandër Prosi” (Sauk)
- Gjimnazi “Sami Frashëri”
- Instituti Harry Fultz
- Gjimnazi “Abdulla Keta” (Shkozë)
- Gjimnazi “Petro Nini Luarasi”
- Gjimnazi “Ibrahim Hoqemama” (Mullat)

Trajnime në grupe sipas prirjeve në fushën e teatrit

Ky projekt u jep mundësinë të rinjve më të spikatur për të asistuar pranë trupës së personelit të TK , në aktrim,regji,skenografi, kostumografi ,make-up artistik, teknik audio e video, teknik ndriçimi etj. ku të rinjve më të talentuar do t'u jepet mundësia për t'u bërë pjesë e produksioneve të teatrit. Ky projekt zhvillohet jo vetëm në identifikimin e elementeve të talentuar si aktorë apo regjisor, por edhe në identifikimin e elementeve të rinj me prirje profesionale të tjera që janë pjesë e rëndësishme e krijimit të një shfaqjeje teatrale. Të rinjtë me prirje si specialist i efekteve audio-vizuale për teatrin dhe teknikë ndriçimi do të trajnohen nga punonjësit e Teatrit Kombëtar dhe do të fitojnë një eksperiencë të vlefshme në këtë profesion.